



## NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 25 qershor 2020, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>	<b>Zëvendëskryetar</b>
<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>	<b>Anëtar</b>

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Miratimin e shtojcës së Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik, (karakteristikat teknike të rrjeteve numerike dhe stacioneve radio FM)". (**Vendimi nr. 44, datë 25.06.2020**)
2. Dhënien e licencës private kombëtare të transmetimit audio analoge, shoqërisë "Radio Klan" sh.a., për subjektin audio "Radio Klan", për të mbuluar me sinjal audio, territorin e Republikës së Shqipërisë" dhe bërjen të pavlefshme të licencës së shoqërisë "Radio Klan" sh.a., për transmetime audio analoge rajonale me zonë ofrimi shërbimi në Qarqet Tiranë, Durrës, Fier dhe Vlorë. (**Vendimi nr. 45, datë 25.06.2020**)
3. Dhënien e licencës për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm shoqërisë "Tema Tv" sh.p.k., për subjektin "TvT" në allotmentet Fier, Berat dhe Korçë. (**Vendimi nr. 46, datë 25.06.2020**)
4. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë "Maqellara TV Kabllor" sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor "Tv Kabllor Maqellara" në njësinë administrative Maqellarë dhe rrëzimin e kërkesës për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në njësinë administrative Gjoricë". (**Vendimi nr. 47, datë 25.06.2020**)
5. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Ismet Drishti, për ofrimin e shërbimit audioviziv online "Zjarr TV". (**Vendimi nr. 48, datë 25.06.2020**)
6. Zvogëlimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit person fizik Rramazan Rringaj, autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjetin kabllor "TV kabllor Puka", duke hequr dorë nga zona "Njësia administrative Qelëz". (**Vendimi nr. 49, datë 25.06.2020**)
7. Çeljen e garës për lëshimin e licencës lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm në allotmentin Tiranë". (**Vendimi nr. 50, datë 25.06.2020**)

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 25 qershor 2020